



Berisha, më i votuari nga tifozët

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) për herë të parë ka vendosur që të shpall Lojtarin më të mirë të zgjedhur nga tifozët për stinorin vjeshtor në Art Motion Superligë. Basketbollistët e nominuar ishin: Drilon Hajrizi (Trepça), Erjon Kastrati (Golden Eagle Ylli), Dardan Berisha (Peja), Ivan Koljeviq (Prizreni 16) dhe Julien Lewis (Bashkimi). Dardan Berisha ka marrë më shumë vota, gjithsej 519, duke u renditur në vendin e parë. Pas tij në vendin e dytë ishte Drilon Hajrizi me 337 vota, Erjon Kastrati ishte i treti me 255 vota, Julien Lewis mori 77 dhe Ivan Koljevq 71.



Kapitenia e Penzës më e votuara nga tifozët te femrat

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) për herë të parë ka vendosur që të shpall Lojtaren më të mirë nga tifozët për stinorin vjeshtor në Superligën e Femrave. Lojtaret e nominuara ishin Sarah Mgbeike dhe Arbnore Përçuku nga Prishtina, Valbona Bytyqi dhe Rael Whitsitt të Penzës dhe Irma Konjusha nga Bashkimi. Basketbollistja më e votuar nga tifozët ishte kapitenia e Penzës, Valbona Bytyqi me 714 vota, duke u renditur në vendin e parë. E dyta ishte Irma Konjusha e Bashkimit me 365 vota. Arbnore Përçuku u radhit e treta me 102 vota, kurse pas saj ishte Rael Whitsitt me 95 dhe Sarah Mgbeike me 43.





Dushku shpalos objektivat e saj me FBK-në në mandatin e dytë si Sekretare e Përgjithshme

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Elvira Dushku në mbledhjen e fundit të Bordit të FBK-së për vitin 2021 konform Statutit të FBK-së dhe me propozim të Kryetarit të FBK-së, Arben Fetahu është riemëruar edhe për një mandat shtesë (4 vjeçar) në këtë pozitë. Përkushtimi në punë dhe performanca e shkëlqyeshme në detyrat e saj bënë që Bordi i FBK-së njëzëri të miratojë propozimin e Kryetarit Fetahu për riemërimin e Dushkut në këtë pozitë, e që në fakt është një post që sjell me vete shumë përgjegjësi, por është edhe nder e privilegj të jesh Sekretare e Përgjithshme e Federatës së dytë më të madhe sportive në vendin tonë. Dushku në vitin 2017 ishte emëruar ushtruese e detyrës së Sekretares së Përgjithshme, ndërsa pas një viti Bordi i FBK-së ia kishte besuar postin e Sekretares së Përgjithshme me mandat 4 vjeçar. Atëbotë, Dushku ka qenë e vetmja grua në pozitën e ekzekutives në një Federatë apo organizatë sportive. Dushku për faqen zyrtare të FBK-së ka folur për të arriturat me FBK-në në mandatin e saj të parë dhe për punën që e pret në mandatin e dytë së bashku me Bordin, stafin e zyrës ekzekutive dhe të gjitha grupet e tjera të interesit të Federatës.





Prof. Dr. Ridvan Ekmekçi ligjëron para basketbollistëve të Qendrës Nacionale

Qendra Nacionale e Basketbollit po vazhdon punën pandërprerë. Në këtë Qendër Nacionale janë grumbulluar basketbollistët U15 nga e tërë Kosova e që llogariten e ardhmja e basketbollit kosovar. Qendra Nacionale e Basketbollit është e para dhe e vetmja në vendin tonë, ku janë grumbulluar lojtarët me potencial, që stërviden dy herë në ditë dhe janë akomoduar në Prishtinë, kurse të gjitha shpenzimet mbulohen nga FBK-ja.

Më 9 Janar, basketbollistët i ka vizituar Prof. Dr. Ridvan Ekmekçi nga Turqia. Profesori i njohur ka mbajtur një ligjëratë para basketbollistëve të rinj dhe trajnerëve të Qendrës Nacionale rreth përgatitjes mentale të basketbollistëve. Ai gjithashtu ka bërë edhe testimin mental të lojtarëve, që do të ju ndihmojë shumë në të ardhmen e tyre. Prof. Dr. Ridvan Ekmekçi edhe më parë ka mbajtur ligjëratë për grupmoshat e reja të Kosovës, trajnerëve dhe gjyqtarëve.

Ekmekçi është i njohur për përgatitjen mentale, që ka shumë rëndësi në sport, derisa Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), që disa vite bashkëpunon me profesorin nga Turqia.





Mbahet FIBA SCOD Klinika për gjyqtarët e basketbollit

Më 8 dhe 9 Janar është mbajtur FIBA SCOD Klinika për gjyqtarët e basketbollit. Në këtë Klinikë pjesëmarrës kanë qenë 48 gjyqtarë nga të gjitha listat e gjyqtarëve të FBK-së. FIBA SCOD Klinika është udhëhequr nga FIBA Instruktori Nacional Faton Kurshumlija, Instruktori i Gjyqtarëve të FIBA-s, Gjorgji Piperkov dhe Profesori për përgatitje mentale nga Universiteti Pamukale – Denizli, Ridvan Ekmekçi. Në këtë klinikë janë prezantuar pikat të cilat kanë qenë me rëndësi të veçantë për gjyqtarët e FBK-së: Evaulimi i ndeshjeve të ART Motion Superliga në stinorin vjeshtor të edicionit 2021-2022 nga Faton Kurshumlija, Prezantimi nga njohja e përdorimit ilegal të duarve në ndeshjet e basketbollit, nga FIBA Instruktori i gjyqtarëve Gjorgji Piperkov IUH-HC, si dhe ilustrimi i saj me anë të klipeve dhe rregullave të basketbollit, Prezantimi nga përgatitja Mentale e Gjyqtarëve ka pasur një rëndësi shumë të veçantë për gjyqtarët sepse në këtë prezantim Prof. Ridvan Ekmekçi ka prezantuar pikat më të avancuara të përgatitjeve mentale, Punëtorja (workshop) për gjyqtarët e nominuar në ndeshjet e ART Motion Superliga për evaulimin e klipeve nga ndeshjet e ART Motion Superliga në stinorin vjeshtor të edicionit 2021-2022, IOT - Mekanika 3PO, prezantuar nga FIBA Instruktori i Gjyqtarëve Gjorgji Piperkov, si dhe ilustrimi i saj me anë të klipeve dhe rregullave të basketbollit. Në "Zoom Online" të gjithë pjesëmarrësve i është drejtuar Menaxheri i Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA-s, Davorin Nakic, i cili ri-përsëriti rëndësinë e implementimit të FIBA SCOD Projektit, ku shumë lartë vlerësoi investimet e FBK-së, gjyqtarët, punën e FIBA Instruktorit Nacional, Faton Kurshumlija, FIBA Instruktorit Gjorgji Piperkov, në organizimet e Klinikave dhe trajnimeve tjera, ku FBK e ka renditur si udhëheqëse e SCOD Projekteve nga shtetet e vogla. Gjithashtu është zhvilluar Testi nga Rregullat e Basketbollit nga FIBA Instruktori Nacional Faton Kurshumlija dhe është udhëhequr nga SHGJFBK, ku 48 gjyqtarë i janë nënshtruar testeve, ku nga 25 pyetje, 20 ka qenë të obliguara të jenë të sakta. Rezultati i tyre ka qenë shumë i mirë nga të gjithë gjyqtarët. Të dielën është mbajtur Testi nga Përgatitja Mentale për 20 gjyqtarë perspektiv-potencial, i cili është udhëhequr nga Prof. Dr. Ridvan Ekmekçi, ku pas testimit të gjyqtarëve i janë dhënë detyra, ushtrime për 3 muajt e ardhshme për përmirësimin e tyre. Prof. Ridvan Ekmekçi gjatë tre muajve të ardhshëm në vazhdimësi (pa pagesë) do të organizojë edhe Zoom takimin online me gjyqtarët të testuar ku do të përcjellë situatën e tyre pas ushtrimeve dhe detyrave të dhënë atyre. Faton Kurshumlija është shprehur i kënaqur me rrjedhën e Klinikës dhe rëndësinë që ka para fillimit të garave, ndërsa shtoi se gjyqtarët janë gati për stinorin pranveror.





Fetahu e vlerëson lartë organizimin e "Tryezës së Sportit"

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu ka marrë pjesë në ngjarjen dy ditore (22-23 Janar) "Tryeza e Sportit" që është organizuar nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës (MKRS) në Brezovicë, ku akterët më të lartë vendor të komunitetit sportiv, diskutuan tema të ndërlidhura me këtë fushë, me qëllim të ndërtimit të vizionit për të ardhmen e zhvillimit të sportit në Kosovë. "Organizimi i 'Tryezës së Sportit' është një vendim më se i qëlluar dhe Federata e Basketbollit të Kosovës e ka mirëpritur ndarjen e informatave dhe ftesën për të ndikuar direkt në planin operativ të këtij viti. "Mendoj se prioritet për gjithë komunitetin e sportit duhet të jetë Strategjia e Sportit. Jemi të vetëdijshëm se procedura është e gjatë dhe e mundimshme, mirëpo për këtë arsye duhet të reagohet sa më shpejtë", ka thënë Arben Fetahu për faqen zyrtare të FBK-së në lidhje me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës në "Tryezën e Sportit". Sipas MKRS-së në këto diskutime u arritën disa përfundime dhe pajtueshmëri, të cilat do të ndihmojnë në orientimin e qeverisë dhe komunitetit të gjerë sportiv drejt zhvillimit të mëtejshëm të sportit në vend. Në përmbyllje të tryezës dy ditore, mori pjesë edhe Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, për të ritheksuar vëmendjen dhe dedikimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e sportit.



Vendim i Bordit të FBK-së

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) e ka miratuar kërkesën e KB Peja për organizimin e Final 8 Kupës së Kosovës në basketboll në datat 09-13 Shkurt 2022, pasi skuadra nga Peja i ka plotësuar kushtet e përcaktuara në konkursin për organizimin e Final 8 Kupës së Kosovës. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.





Vlora Braha, Personi Kontaktues për Integritet (SPOC) në Federatën e Basketbollit të Kosovës

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 1 nëntor 2021 e ka emëruar Vlora Brahën si Person Kontaktues për Integritet (SPOC) në FBK. Kjo pozitë është krijuar me kërkesë të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA). Në Shtator 2021, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku e ka përfunduar me sukses programin e FIBA-s të ashtuquajtur SWISH, që ka qenë i fokusuar në zhvillimin e Integritetit në Sport në Federatat Nacionale. Pas përfundimit të këtij programi, FIBA ka kërkuar nga Federatat Nacionale, gjegjësisht anëtarët e saj, krijimin e pozitës së SPOC-ut dhe kështu ka vepruar edhe Federata e Basketbollit të Kosovës, duke e emëruar ish-basketbollisten e shumëtrofeshme Vlora Braha. Vlora Braha gjithashtu është pjesë e misionit paqeruajtës të KFOR-NATO-s në Kosovë, në të cilin punon tash e mbi 20 vjet si përkthyes.



Mbahet Punëtorja për Implementimin e Sportit të Unifikuar

Përfundoi Punëtorja për Implementimin e Sportit të Unifikuar, që u mbajt nga 28 deri më 30 Janar, e që u organizua nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) në bashkëpunim me Organizatën Olimpiada Speciale të Kosovës, SO Germany, si dhe GIZ. Punëtorja ka të bëjë me Implementimin e Sportit të Unifikuar. Kjo punëtori është mbajtur për herë të parë në Kosovë dhe kishte për qëllim Implementimin e Sportit të Unifikuar në shoqërinë tonë, si në shkolla, klube e tjera.

Pikërisht në punëtorinë e parë i është dhënë prioritet basketbollit si sport, ndërsa nga Federata e Basketbollit të Kosovës ishin të ftuar tre trajnerë: Driton Obërtinca, Agnesa Robaj dhe Valentin Spaqi. Fëmijët kanë luajtur së bashku të shtunën dhe të dielën në basketboll, duke u argëtuar mes tyre, që kishte për qëllim shoqërimin mes tyre dhe integrimin.

Në këtë punëtori ligjërues ishte Micheal Newton dhe Tobias Antoni. Federata e Basketbollit të Kosovës është shumë e lumtur që e ka ndihmuar këtë Punëtori, duke ofruar ndihmën e tyre dhe duke u shprehur e gatshme që t'iu ndihmojë edhe në herët e ardhshme dhe projekte të ngjashme.





Rugova jep dorëheqje, FBK i uron suksese për të ardhmen

Më 3 Shkurt, Granit Rugova ka dhënë dorëheqje nga posti i Drejtorit të Përfaqësueseve të Kosovës.

Rugova e mori këtë detyrë më 15 Gusht 2018, kur vendosi të pensionohet nga basketbolli aktiv dhe të punojë si Drejtor i Përfaqësueseve të Kosovës. Rugova ka fituar shumë trofe me klubin e Sigal Prishtinës, derisa luajti edhe për Bashkimin, si dhe ishte pjesë e rëndësishme e Përfaqësueses së Kosovës në garat ndërkombëtare. Ai përfundoi me sukses programin FIBA Time Out 2.0, ndërsa në dhjetor të vitit të kaluar u zgjodh si ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv në Ligën Unike.

Për 3 vjet e gjysmë sa ishte pjesë e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Graniti punoi me përkushtim e përgjegjësi, duke dhënë më të mirën e tij në punë dhe kjo i hapi dyert për suksese tjera. Ish-basketbollisti i njohur tashmë do të jetë Drejtor në Departamentin e Sportit në Komunën e Prishtinës, një pozitë shumë e rëndësishme për të dhënë kontributin e tij për sportistët prishtinas. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku dhe Bordi i FBK-së e falënderojnë për kontributin e tij, duke i uruar shumë suksese në detyrën e re.



Vendimet e Bordit të FBK-së

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 03.02.2022 në Prishtinë ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin kosovar dhe, ndër të tjera, ka vendosur si në vijim:

I ka miratuar Raportet e Punës dhe ato Financiare të muajit Janar;

E ka miratuar sistemin e garave në basketbollin 3x3 në FBK;

E ka miratuar kërkesën për mbështetje financiare të FIBA3x3 Challenger që do të organizohet nga 3x3 Prishtina;

E ka miratuar dorëheqjen e Drejtorit të Përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova nga kjo pozitë për shkak të angazhimit të tij si Drejtor i Sportit dhe Rinisë në Komunën e Prishtinës;

I ka emëruar përzgjedhësit e Përfaqësueseve të Reja të Kosovës:

U20 Femrat: Furkan Saglik - Përzgjedhës dhe Emrah Karatas – ndihmëstrajner;

U20 Meshkujt - Dritëro Sefaja - Përzgjedhës dhe Dion Pllana – ndihmëstrajner;

U18: Ilir Selmani - Përzgjedhës dhe Donat Musa – ndihmëstrajner;

U16: Valentin Spaqi - Përzgjedhës dhe Driton Obërtinca - ndihmëstrajner.

Ka vendosur që Kuvendi i Rregullt i FBK-së të mbahet më 24 Mars në Prishtinë;

E ka emëruar Blerim Vuniqin si anëtar të Bordit Drejtues në Ligën UNIKE;

Ka vendosur që Workshop-i i Klubeve në organizim të FIBA-s dhe FBK-së të organizohet më 26 e 27 Shkurt në Prishtinë;

Ka vendosur që drafti i Jr NBA të mbahet më 23/24 Shkurt në Prishtinë.

Vendimet hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre.





Kupa me ceremoni spektakolare

Final 8 i Kupës së Kosovës Agim Lluka ka filluar (9 Shkurt) me një ceremoni spektakolare.

Kjo ndodhi para super derbit mes Pejës dhe Sigal Prishtinës. Violinisti i njohur, Festim Fanaj ka performuar me këngën e njohur "Mora Fjalë" dhe "Bareshën", ndërsa rreth tij ishin flamujt e Kosovës, FBK-së dhe tetë skuadrave pjesëmarrëse. Kryetari i KB Peja, Fatmir Gashi ka ndarë mirënjohje për familjen Lluka, për kontributin e madh që ka dhënë për Klubin e Pejës dhe basketbollin e Kosovës.

Hapjen zyrtare e ka bërë kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke u uruar fat të gjitha skuadrave pjesëmarrëse. Fetahu u ka bërë thirrje të gjithëve të vaksinohen, ndërsa shtoi ky edicion është special, pasi i kushtohet Agim Llukës, i cili ka dhënë shumë për basketbollin e Kosovës.

Në fund është shfaqur dokumentari për nder të Agim Llukës, që dha shumë për basketbollin e Kosovës. Kupa u organizua nga 9 deri më 13 Shkurt në qytetin e Pejës.



Dushku: 'Krijimi i databazës së sportit në Kosovë', e rëndësishme për zhvillimin strategjik të sportit në Kosovë

Në kuadër të projektit "Databaza e Sportit në Kosovë" u mbajt takimi me përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave sportive, për të diskutuar rreth krijimit të një forme sa më të përshtatshme dhe të vlefshme për mbledhjen e të dhënave. Pjesëmarrëse e kësaj ngjarje ishte edhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku, e cila e ka mirëpritur këtë iniciativë. "Federata e Basketbollit të Kosovës e ka mirëpritur projektin 'Krijimi i databazës së sportit në Kosovë', dhe e vlerëson si shumë të rëndësishëm për procese të ndryshme të zhvillimit strategjik të sportit në vendin tonë. Kjo data bazë do t'i shërbejë të gjithë komunitetit të sportit në Kosovë. Andaj Federata e Basketbollit të Kosovës dhe klubet e saj do të jenë në shërbim të MKRS-së nëpërmjet organizatës së kontraktuar nga Ministria për sigurimin e të dhënave për krijimin e kësaj data baze". Fillimisht u prezantua projekti dhe draft-forma e paraparë për mbledhjen e të dhënave. Më pas u mirëpritën sugjerimet e të pranishmëve, të cilët me idetë dhe mbështetjen e tyre për projektin ndihmuan që diskutimet të jenë mjaft konstruktive dhe të dobishme.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komiteti Olimpik i Kosovës, federatat e ndryshme sportive në vend dhe institucionet e arsimit të lartë, të cilët ofruan përkrahjen e tyre gjatë këtij procesi. Falënderojmë përzemërsisht të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi të cilët iu përgjigjën ftesës sonë dhe kontribuan me diskutimet e tyre!

Duke pasur parasysh rëndësinë e përfaqësuesve të sportit në realizimin e këtij projekti, në vazhdim do të zhvillohen bashkëpunime edhe më të ngushta me Komitetin Olimpik dhe të gjitha federatat sportive të Kosovës, me qëllim të dakordimit dhe lehtësimin të realizimit të këtij projekti.





New Basket fiton Kupën e Ligës së Parë

New Basket ka shënuar fitore ndaj Istogut me rezultat 69:72 (24:19, 16:24, 16:15, 13:14), duke e fituar Kupën e Kosovës për Ligën e Parë. Medaljet i ndan Sekretari i Klubit, Gazmend Pupovci dhe Komesari i Garave të FBK-së, Faton Kurshumlija. MVP i turneut është shpallur Hajriz Hajzeri, çmim të cilin ia ndau Menaxherja e Eventeve dhe Basketbollit 3x3, Artina Hasani. Ndërkohë, Kupën kapitenit të New Basket, Idol Pallushi ia dorëzoi anëtari i Bordit të FBK-së, Dardan Kasapolli.



Bashkimi triumfon ndaj Prishtinës dhe fiton Kupën

Bashkimi ka mundur Prishtinën 54:69 (16:16, 15:8, 13:24, 10:21), për të triumfuar në Kupën e Kosovës në konkurrencën e femrave. Medaljet i kanë ndarë kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, kryetari i KB Peja, Fatmir Gashi dhe dy anëtarët e Bordit të FBK-së, Valton Bilalli dhe Leart Hoxha. MVP e turneut është shpallur Sarra Vraniqi, çmim të cilin ia ndau Linda Shala, nënkryetare e FBK-së. Ndërkohë, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku ia dorëzoi Kupën, kapitenes së Bashkimit, Ulpiana Emra.



Trepça e jashtëzakonshme, triumfon për Kupë

Trepça ka mundur Bashkimin me rezultat 76:62 (19:26, 18:10, 16:15, 23:11), duke fituar Kupën e Kosovës në basketboll. MVP i turneut është zgjedhur Drilon Hajrizi, çmim të cilin ia ndau djali i të ndjerit Agim Lluka, Rron Uka. Medaljet i kanë ndarë, nënkryetarja e FBK-së, Linda Shala, nënkryetari i FBK-së, Artan Kurti, Anëtari i Bordit të FBK-së, Leart Hoxha dhe Kryetari i KB Peja, Fatmir Gashi. Ndërkohë, kryetari i FBK-së, Arben Fetahu ia dorëzoi trofeun e Kupës, kapitenit të Trepçës, Valdrin Haxhiu.





Hidhet shorti për garat ndërkombëtare ku garon Kosova

Më 15 Shkurt në Freising të Gjermanisë është hedhur shorti për Kampionatet Evropiane për kategori të reja, si dhe Shtetet e Vogla. Në këtë short kanë qenë pjesëmarrëse edhe Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Rinjve në FIBA, si dhe Artina Hasani, Menaxhere e Eventeve dhe Basketbollit 3x3 në FBK. Dushku e hodhi shortin për Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla të meshkujt, për Divizionin C për U18 të meshkujt, si dhe U16 për meshkujt, që do të zhvillohet në Kosovë.

Në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në konkurrencën e femrave, vashat Dardane do të garojnë në Grupin A, së bashku me Qipron, Andorrën, Norvegjinë dhe Maltën. Kampionati mbahet nga 28 Qershori deri më 3 Korrik në Qipro.

Vashat e Kosovës U20 garojnë në Divizionin B dhe kanë një short shumë të vështirë. Në Grupin C do të sfidojnë Kroacinë, Rumaninë, Malin e Zi dhe Maqedonia Veriore. Kampionati zhvillohet në Shkup nga 9 deri më 17 Korrik në Shkup.

Në Evropianin e Divizionit C që do të mbahet në Kosovë do të garojnë tetë shtete që janë ndarë në dy grupe. Kosova U16 e meshkujve do të jetë në grup me Shqipërinë, San Marinon dhe Maltën, kurse në Grupin tjetër janë Andorra, Gjibraltari, Moldavia dhe Armenia. Kampionati zhvillohet 12 deri më 17 Korrik.

Kosova U18 të meshkujt do të jetë në grup me Holandën, Bosnja e Hercegovinën, Bullgarinë, Gjeorgjinë dhe Norvegjinë. Garat mbahen në Oradea të Rumanisë nga 29 Korriku deri më 7 Gusht. Kosova U20 të meshkujt është në grup me Suedinë, Gjeorgjinë, Maqedoninë Veriore dhe Austrinë. Kampionati mbahet në Tbilisi të Gjeorgjisë nga 15 deri më 24 Korrik.





Është mbajtur FIBA SCOD Kampi i Gjyqtarëve të Final 8

Më 9 dhe 11 Shkurt është mbajtur FIBA SCOD Kampi i Gjyqtarëve të basketbollit, të cilët kanë gjykuar në Final 8 Kupës së Kosovës Agim Lluka, që u zhvillua në Pejë.

Me kërkesën e FIBA Instruktorit Nacional dhe me aprovimin e kërkesës nga Menaxheri i Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA-s, Davorin Nakic, evaulues në të gjitha ndeshjet e Kupës së Kosovës (7 ndeshje të Final Eight Kupa e Kosovës) Video Observer ka qenë Instruktori i FIBA-s, Gjorgi Piperkov. Faton Kurshumlija, si FIBA Instruktor Nacional, ka ligjëruar këto tema: Evaulimi i klipeve nga ndeshjet e ART Motion Superligës (kriteri, shkeljet, komunikimi, IRS situatat, lëshimet, korrigjimet, etj), Komunikimi gjyqtarë-trajnerë-lojtarë, Skautimi i ekipeve (lojtarët, trajnerët), Rishikimi IRS situatave, Evitimi i situatave konfliktuoze, Menaxhimi i bankinave, Flop-cheating lojtarët në Superligën e Kosovës, Përgjegjësia e gjyqtarëve, Paraqitja e pikave për diskutim në Pre Game, IOT- Mekanika 3 PO, Monitorimi i DSS nga Vëzhguesit e ndeshjes dhe Prezantimi i nominimit në ndeshjet e Final 8. Ligjërues ishte edhe Prof. Doc. Ridvan Ekmekci rreth përgatitjeve mentale të gjyqtarëve për menaxhimin sa më të mirë të situatave të stresit dhe rrezikut të lartë. Ai ligjëroi këto tema: Motivimi, Organizimin e Pre Game, Përqendrimi i gjyqtarëve, Përgatitja mentale, Përgatitja fizike dhe Përqendrimi.

Grumbullimi i Kosovës U20

Më 18 Shkurt në palestrën '1 Tetori' u mbajt grumbullimi i parë seleksionues i Kosovës U20 në konkurrencën e meshkujve. Më pas kishte edhe dy grumbullime të tjera kjo kategori.

42 lojtarë janë nën vëzhgimin e Dritëro Sefajës, ndërsa për këtë grumbullim do të jetë të ftuar vetëm basketbollistët që luajnë në Kosovë.

Lista e gjerë: Shpat Mustafa, Nart Jashari, Hajriz Hajzeri, Ensar Muriqi, Emanuel Gegaj, Enis Morina, Diellor Maksuti, Nart Llapashtica, Shendrit Llapi, Idon Pallushi, Diart Gashi, Enver Memcaj, Enes Huduti, Albin Berisha, Ermal Mala, Sokol Nila, Adhurim Alijaj, Albin Rexhepi, Arber Rushiti, Leurit Morina, Endrit Qovanaj, Besmir Memaj, Visar Ejupi, Don Polloshka, Bledar Thaqi, Donat Rexhepi, Rinol Gashi, Shpat Sylja, Blend Mehana, Bleonis Tanushi, Albin Haxhismajli, Albion Imeri, Erlind Uka, Drilon Shala. Ndërkohë, basketbollistët që luajnë jashtë Kosovës janë: Rroni Koshi, Fatlind Shoshaj, Albatrit Sylja, Gezim Bajrami, Denis Zenelaj, Bardh Istrefi, Drilon Pllana dhe Dion Sheqiri.





Është mbajtur FIBA SCOD Kampi i Gjyqtarëve të Final 8

Më 9 dhe 11 Shkurt është mbajtur FIBA SCOD Kampi i Gjyqtarëve të basketbollit, të cilët kanë gjykuar në Final 8 Kupës së Kosovës Agim Lluka, që u zhvillua në Pejë.

Me kërkesën e FIBA Instruktorit Nacional dhe me aprovimin e kërkesës nga Menaxheri i Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA-s, Davorin Nakic, evaulues në të gjitha ndeshjet e Kupës së Kosovës (7 ndeshje të Final Eight Kupa e Kosovës) Video Observer ka qenë Instruktori i FIBA-s, Gjorgji Piperkov. Faton Kurshumlija, si FIBA Instruktor Nacional, ka ligjëruar këto tema: Evaulimi i klipeve nga ndeshjet e ART Motion Superligës (kriteri, shkeljet, komunikimi, IRS situatat, lëshimet, korrigjimet, etj), Komunikimi gjyqtarë-trajnerë-lojtarë, Skautimi i ekipeve (lojtarët, trajnerët), Rishikimi IRS situatave, Evitimi i situatave konfliktuoze, Menaxhimi i bankinave, Flop-cheating lojtarët në Superligën e Kosovës, Përgjegjësia e gjyqtarëve, Paraqitja e pikave për diskutim në Pre Game, IOT- Mekanika 3 PO, Monitorimi i DSS nga Vëzhguesit e ndeshjes dhe Prezantimi i nominimit në ndeshjet e Final 8. Ligjërues ishte edhe Prof. Doc. Ridvan Ekmekci rreth përgatitjeve mentale të gjyqtarëve për menaxhimin sa më të mirë të situatave të stresit dhe rrezikut të lartë. Ai ligjëroi këto tema: Motivimi, Organizimin e Pre Game, Përqendrimi i gjyqtarëve, Përgatitja mentale, Përgatitja fizike dhe Përqendrimi.

Drejtuesit e FBK-së presin përfaqësuesit e Junior NBA-së për Kosovë

Më 21 Shkurt drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) kanë pritur Jiri Welsch, ambasador i Junior NBA dhe ish-basketbollist i NBA-së, si dhe Adrian Carrion, përgjegjës i Jr NBA për Kosovë. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, së bashku me Sekretaren e Përgjithshme të FBK-së, Elvira Dushku dhe Drejtorin Teknik, Arben Krasniqi kanë mirëpritur Welsch dhe Carrion, ndërsa kanë biseduar për fillimin e një projekti shumë të rëndësishëm për basketbollin e Kosovës, fillimin e Junior NBA Kosova.

Welsch dhe Carrion kanë falënderuar drejtuesit e FBK-së për mikpritje dhe bashkëpunimin e ngushtë, që do të finalizohet me Junior NBA Kosova. Junior NBA Kosova është një projekt shumë i rëndësishëm për basketbollin e Kosovës.





Welsch dhe Carrion mbajnë stërvitje me fëmijët kosovarë

Jiri Welsch, ambasador i Junior NBA dhe ish basketbollist i NBA-së, si dhe Adrian Carrion, përgjegjës i Jr NBA për Kosovë pas takimit me drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës më 15 Shkurt kanë mbajtur një stërvitje me fëmijët kosovarë.

Ata gjatë stërvitjes me djem dhe vajza ju kanë treguar atyre se sa e rëndësishme është shoqërimi mes vete dhe integrimi, ndërsa fëmijët basketbollistët e rinj kanë pasur mundësi të mësojnë shumë nga ata. Carrion ka qenë në shumë vende të botës, dhe u ka mësuar fëmijëve disa ushtrime bazike, ndërsa Welsch ka bartur përvojën e tij tek fëmijët e Kosovës, që ishin shumë të lumtur të takonin një ish-basketbollist të NBA-së. Stërvitje ka zgjatur më shumë se një orë dhe ishte shumë atraktive për fëmijët, kurse më pas djemtë dhe vajzat kanë bërë pyetje për Welsch, i cili ka luajtur për katër vite në NBA, për skuadrat Golden State Warriors, Boston Celtics, Cleveland Cavaliers dhe Milwaukee Bucks, si dhe pjesë e disa skuadrave evropiane, ku fitoi shumë trofe.

Ish basketbollisti i Republikës së Çekisë u ka thënë fëmijëve se duhet të punojnë shumë dhe të mos ndalen asnjëherë për të realizuar ëndrrat e tyre. Ai shtoi se vjen nga një fshat i vogël dhe është dashur që të punojë shumë, që një ditë të luajë në Ligën më të fortë në Botë.

Welsch theksoi se përvoja në NBA ishte e jashtëzakonshme, duke u uruar fëmijëve kosovarë që të përjetojnë emocione të tilla, por duhet të punojnë shumë. Si Welsch, ashtu edhe Carrion, ishin të kënaqur me interesimin e fëmijëve për basketboll, ndërsa u kanë uruar sukses në Ligën Junior NBA Kosova, që do të fillojë së shpejti.





Me ceremoni zyrtare hidhet shorti për Junior NBA Kosova

Më 22 Shkurt ka filluar një projekt shumë i rëndësishëm për basketbollin e Kosovës, Junior NBA Kosova. Me një ceremoni zyrtare është hedhur shorti për Junior NBA Kosova. 30 Shkolla Filllore të gjeneratës 11-14 vjeç janë ndarë në dy Konferenca, apo gjashtë Divizione. Tetë më të mirat e Konferencës kualifikohen në "Play-off" dhe më pas zhvillohet "Final Four", ku shpallet skuadra kampione.

Hapjen e Draft Shortit, e ka bërë kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, i cili ka theksuar se ky është një projekt shumë me rëndësi për gjeneratat e reja, por edhe basketbollin e Kosovës, ndërsa shtoi se është i lumtur që edhe Kosova është pjesë e Ligës Junior NBA.

Zëvendësministrja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, ka përshëndetur fillimin e këtij projekti, për të theksuar se janë të lumtur që e mbështesin, ashtu si shumë projekte të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

Ish basketbollisti i NBA-së, Jiri Welsch, ambasador i Junor NBA, ju ka drejtuar të pranishmëve me rëndësinë që ka Junior NBA dhe sa është e dobishme për basketbollin, ku shumë lojtarë mund të dalin dhe të jenë kyç për të ardhmen e basketbollit të Kosovës. Welsch nënvizoi se është shumë i kënaqur me mikpritjen që i është bërë dhe do të largohet me përshtypje shumë të mira për Kosovën. Adrian Carrion përgjegjës i Junior NBA Kosova shtoi se për këtë projekt kanë biseduar para më shumë se dy viteve me drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe tashmë gjithçka po finalizohet, duke besuar se do të jetë një projekt shumë i rëndësishëm dhe i frytshëm për Kosovën.

Më pas është bërë hedhja e shortit, ku 30 Shkolla Filllore janë ndarë në Divizione e Konferenca, varësisht nga regjionet që janë.





FIBA dhe FBK bëjnë rishikimin e 12 mujorit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025

Përgjegjësja për Federatat Nacionale në FIBA Evropë, Radmila Turner dhe eksperti për strategji dhe marketing i organizatave sportive, Geoff Wilson më 24 Shkurt i kanë vizituar zyrat e reja të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Me këtë rast ata kanë zhvilluar një takim pune me Kryetarin e FBK-së, Arben Fetahu dhe Sekretaren e Përgjithshme, Elvira Dushku. Turner dhe Wilson i kanë përgëzuar krerët e FBK-së me punën e bërë në vitin e parë të implementimit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025 dhe të arriturat në kuadër të këtij plani. Në anën tjetër Kryetari Fetahu e ka falënderuar FIBA-n për gatishmërinë e treguar në mbështetje të FBK-së, por edhe të klubeve të saj, ku në fundjavë FBK në bashkëpunim me FIBA-n do të organizojnë Seminarin për Klubet e basketbollit.

Krahas këtij takimi Turner dhe Wilson, së bashku me Dushkun dhe Drejtorin Teknik në FBK, Arben Krasniqi e kanë bërë rishikimin e 12 mujorit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025.

Federata e Basketbollit të Kosovës në mars të vitit 2021 e ka lansuar edhe zyrtarisht Planin Strategjik 2021-2025, të cilin e ka hartuar në bashkëpunim me FIBA-n në një proces që ka zgjatur tetë muaj dhe në të cilin kanë marr pjesë pikërisht Turner dhe Wilson, si dhe ekspertë të tjerë të angazhuar nga FIBA.



E tashmja dhe e ardhmja ...

Më Shkurt pas stërvitjes së Kosovës A është zhvilluar një aktivitet me fëmijët, që luajnë basketboll në Kosovë. 12 fëmijë kanë pasur mundësi t'i takojnë basketbollistët e Kosovës A, duke shpresuar se, një ditë do të luajnë për ekipin kombëtar të Kosovës. Përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos ka mbajtur një fjalim para fëmijëve, duke i motivuar që të punojnë dhe të mos ndalen, në mënyrë që të realizojnë ëndrrat e tyre, të jenë pjesë e Kosovës A. Aktiviteti është organizuar nga Menaxherja e Eventeve dhe Basketbollit 3x3 në FBK, Artina Hasani. Fëmijët më pas kanë luajtur me lojtarët e Kosovës, kurse basketbollistët iu kanë dhuruar nga një fanellë dhe një fotografi me mbishkrim për fëmijët si kujtim. Fëmijët ishin shumë të lumtur që kanë pasur mundësi t'i takojnë basketbollistët e Kosovës, me shpresë se do të realizojnë ëndrrën që të luajnë për Kosovën A.





Kryetari Fetahu hap Seminarin për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Klubeve të FBK-së

Në Prishtinë më 26 Shkurt u hap Seminarin për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Klubeve të FBK-së. Ky Seminar organizohet nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA). Hapjen e Seminarit e ka bërë Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu. "Jemi shumë të lumtur që po organizojmë këtë Seminar, që është shumë i rëndësishëm për klubet tona, sidomos për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre. FBK është e vendosur që të mbështesë klubet tona, duke i ndihmuar ato, ndërsa një Seminar tjetër do të organizohet në muajin Prill. Këto Seminare shërbejnë si ndihmesë për klubet në organizimet që do t'i kenë, e që janë shumë të rëndësishme për ne. FBK ka organizuar me sukses gara vendore dhe ndërkombëtare, andaj është e rëndësishme që klubet të jenë të përgatitura për organizime të tilla. Ne kemi bërë përvojë dhe këtë duam ta bartim te klubet tona", është shprehur Fetahu para të pranishmëve. Ligjërues në Seminarin janë ekspertë të angazhuar nga FIBA: Geoff Wilson, Maeve Buckley dhe Gustavo Arellano.

Temat për të cilat ata/o ligjërojnë ishin:

Menaxhimi i brendit dhe angazhimi digjital me tifozë.

Veprimet në ditën e ndeshjes dhe angazhimi me tifozë në ditën e ndeshjes.

Sponsorizimi dhe investimet nga sektori publik.

Kjo do të jetë hera e parë që FIBA e organizon një Seminar për Klube në bashkëpunim me një Federatë Nacionale, e në këtë rast me atë të Kosovës.

Krahas ligjëruesve në Seminar dhe në një vizitë pesë ditore në Kosovë do të qëndrojnë edhe Radmila Turner, Përgjegjëse për Federatat Nacionale në FIBA Europe dhe Florian Pasquet, Përgjegjës për Federatat Nacionale në FIBA Bota, të cilët do të jenë në rolin e monitoruesve në Seminarin për Klube dhe njëkohësisht do të zhvillojnë takime me krerët e FBK-së, dhe me stafin e zyrës ekzekutive të FBK-së për të diskutuar për punën që është bërë në vitin e parë të implementimit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025.





Përfundon Seminari për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Klubeve të FBK-së

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) kanë organizuar (26-27 Shkurt) Seminarin për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Klubeve të FBK-së. Kjo ishte hera e parë që FIBA e organizon një Seminar për Klube në bashkëpunim me një Federatë Nacionale, e në këtë rast me atë të Kosovës.

Qëllimi i organizimit të këtij Seminari ishte zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve të basketbollit.

Fuqizimi i Klubeve të FBK-së është një nga pesë qëllimet e FBK-së në Planin Strategjik 2021-2025, të cilin Federata e Basketbollit të Kosovës e ka hartuar në bashkëpunim me FIBA-n dhe ekspertët e jashtëm të angazhuar nga institucioni më i lartë i basketbollit në botë.

Ligjërues në Seminarin ishin ekspertë të angazhuar nga FIBA: Geoff Wilson, Maeve Buckley dhe Gustavo Arellano.



Kosova pëson nga Norvegjia

Kosova ka pësuar humbje nga Norvegjia me rezultat 92:95 (27:15, 19:16, 18:25, 17:25, 11:14), më 27 Shkurt.

Dardanët e nisën ndeshjen për mrekulli ndeshjen, duke pasur epërsi konstante, dhe në çerekun e parë ishin në epërsi të dyfishtë, 22:11, e më pas e thelluan në 27:15, sa përfundoi kjo pjesë.

Basketbollistët e Kosovës e thelluan epërsinë në 30:15, dhe gjatë gjithë periodës së dytë e menaxhuan lojën dhe epërsinë, ku më e larta ishte 46:29, ndërsa pjesa e parë përfundoi 46:31.

Por, në periudhën e tretë mysafirët ishin më të mirë, duke ngushtuar shifrat në vetëm pesë pikë, 56:51, megjithatë, tetë pikë radhazi nga vendasit bënë që të shkëputen në 64:51, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 64:56. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë interesante,





Përfundon Seminari për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Klubeve të FBK-së

ku norvegjezët rikthehen, duke ngushtuar shifrat dhe zhvillohet lojë dramatike deri në fund, ku koha e rregullt përfundoi 81:81. Lojë interesante u zhvillua edhe në pesë minutat shtesë, që përfundoi 92:95. Kosova ka një fitore dhe dy humbje, kurse Norvegjia dy fitore e një humbje në rrethin e parë parakualifikues për Eurobasket 2025.



Marigona Hill Prishtina U18 fiton Kupën e Kosovës

Në 5-6 Mars është zhvilluar Final Four i Kupës së Kosovës në konkurrencën e meshkujve në kategorinë U18.

Në finalen e zhvilluar ndërmjet Trepçës dhe Marigona Hill Prishtinës, ka triumfuar skuadra prishtinase me rezultat 71:85. Ndeshja finale ka qenë shumë interesante, ndërsa në fund ishin prishtinasit që triumfuan.

Eliot Peci është shpallur MVP i turneut. Çmimin e MVP, Kupën dhe medaljet i ka ndarë, anëtar i Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Valton Bilalli.



Kosova, pjesëmarrëse në turneun e YDF-së në Shkup

Kosova në të dyja konkurrencat ka marrë pjesë në turneun e FIBA YDF-së, që u zhvillua më 3-6 Mars në Shkup të Maqedonisë Veriore.

Kosova meshkujt shënoi fitore ndaj Maqedonisë Veriore, Bullgarisë dhe Rumanisë, ndërsa pësoi nga Turqia. Ndërkohë, vajzat kanë mundur Bullgarinë dhe Maqedoninë Veriore, ndërsa kanë pësuar nga Rumania dhe Turqia.





Vendimet e Bordit të FBK-së

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 08/03/2022 ka marrë vendim që: Kuvendi i Punës i FBK-së të mbahet më 25/03/2022 në Prishtinë, e jo siç ishte paraparë në datën 24/03/2022, për shkak se më 23/24 Mars 2022 në program është Final Four i Ligës UNIKE të Femrave. Të hap një mini-afat kalimtar të jashtëzakonshëm (48 orë) për regjistrimin e lojtareve të huaja në Superligën e Femrave, për shkak se disa ekipeve u kanë dështuar lojtarët e huaja që i kanë paraqitur për regjistrim, sepse të njëjtat kanë refuzuar të udhëtojnë në Evropë për shkak të situatës në Ukrainë. Vendimet hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre.

Fillon Junior NBA Kosova

Më 12-13 Mars do të zhvillohet xhiroja e parë dhe e dytë e Junior NBA Kosovës.

30 Shkolla Filllore të gjeneratës 11-14 vjeç janë ndarë në dy Konferenca, apo gjashtë Divizione.

Tetë më të mirat e Konferencës kualifikohen në "Play-off" dhe më pas zhvillohet "Final Four", ku shpallet skuadra kampione.

Ky është një projekt madhor nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), derisa synon të zhvillojë gjeneratat e reja dhe masivizimin e basketbollit në të dyja konkurrencat. Xhiroja e parë dhe e dytë do të zhvillohet në Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Rahovec dhe Gjilan, për të vazhduar më pas në xhirot e ardhshme në qytetet tjera.

AA Prishtina vazhdon dominimin në Kupë, triumfon me U16 femrat

Klubi AA Prishtina ka fituar Kupën e Kosovës në konkurrencën e femrave për U16. Ndodhi kjo më 13 Mars. Kjo është hera e gjashtë radhazi për klubin prishtinas që fiton Kupën e Kosovës për këtë grupmoshë nën drejtimin e Artina Hasanit dhe Astrit Tuhinës, duke dëshmuar dominimin në Kupë në vitet e fundit. Olsa Tahiri e AA Prishtinës është shpallur MVP e Final 4 të Kupës së Kosovës U16. Medaljet i kanë ndarë Artan Kurti, nënkryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Adem Morina, Drejtor i Sportit në Komunën e Prizrenit. Morina e ka ndarë edhe çmimin MVP.





Marigona Hill Prishtina bindëse në finale, fiton Kupën U16

Më 13 Mars, Marigona Hill Prishtina vazhdon me suksese në kategoritë e reja. Skuadra prishtinase ka fituar Kupën e Kosovës për U16 në konkurrencën e meshkujve, duke mundur në finale M Junior me rezultat 32:119. Marigona Hill ishte shumë më e mirë në finale, duke shënuar fitore bindëse.

Në gjysmëfinale, Marigona Hill Prishtina kishte mundur New Basket 49:77, kurse M Junior kishte mundur Vushtrria Basket 64:71. Në Final 4 të zhvilluar në Prizren, MVP i turneut është shpallur Edin Bacevac i Marigona Hill Prishtinës. Medaljet, Kupën dhe trofeun e MVP-së e ka ndarë nënkryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Artan Kurti.



7 vjet nga pranimi i Kosovës në FIBA

Më 13 Mars janë bërë shtatë vjet, kur Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) u bë anëtarja e 215-të e FIBA-s. Ndhmesë të madhe në pranim ishte pranimi i Komitetit Olimpik të Kosovës në atë Ndërkombëtar, ndërsa vitet e tëra të punës, u kurorëzuan me sukses, duke u pranuar në shtëpinë e madhe të basketbollit. Delegacioni i prirë nga ish-kryetari i FBK-së, Erolld Belegu, dorëzoi aplikacionin për anëtarësim në FIBA më 5 shkurt 2015. Përgjigja pozitive erdhi më 13 mars, pas mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të FIBA, që me votim unanim e pranoi Federatën e Basketbollit të Kosovës si anëtarë të vet të 215-të.

Më pas Kosova ishte pranuar edhe në FIBA Evropa. Kosova luan me të gjitha kategoritë në garat ndërkombëtare, duke qenë e barabartë me të gjitha shtetet. Pranimi në FIBA ishte një hap i madh për basketbollin e Kosovës, pas shumë vështirësive, duke hapur dyert për arenën ndërkombëtare. Sot, basketbollistët e Kosovës janë të barabartë me ata ndërkombëtarë, ndërsa shumë gjenerata kishin punuar që kjo ditë të vinte. Kosova ka organizuar me sukses disa gara ndërkombëtare, duke shpërblyer besimin nga FIBA, dhe duke qenë shembull edhe për shumë federata tjera, sa i përket organizimit të ngjarjeve. Basketbollistët dhe basketbollistet e Kosovës po ashtu kanë fituar medalje në garat evropiane, kurse ëndrra e shumë gjeneratave u jetësua më 13 Mars 2015. Tashmë gjeneratat e reja i kanë dyert e hapura për suksese, ndërsa nuk mungon puna nga FBK për masivizimin dhe suksese në arenën ndërkombëtare e vendore.



FIBA

We Are Basketball





Prishtina fiton titullin e parë dhe historik të Ligës Unike

Prishtina ka mundur Penzën me rezultat 65:66 (21:17, 12:24, 10:12, 22:13), në finalen e Ligës Unike për femra. Ky ishte edicioni i parë dhe historik i kësaj gare të femrat, duke shkuar në klubin bardhekaltër. MVP është shpallur Stasha Carey, që e përfundoi ndeshjen me 15 pikë e 16 kërcime, çmim të cilin e ndau nënkryetarja e Komunës së Prishtinës, Donjeta Sahatçiu, ndërsa medaljet i kanë ndarë Elvira Dushku, anëtare e Bordit Drejtues të Ligës Unike, Granit Rugova, Drejtor i Sportit në Komunën e Prishtinës, Linda Shala nënkryetare e FBK-së dhe Blerim Vuniqi, anëtar i Bordit Drejtues të Ligës Unike. Ndërkohë, trofeun e Kupës, kapitenes së Prishtinës, Arbnore Përçuku ia dorëzuan Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Kryetari i FSHB-së, Avni Ponari.





Mbahet Kuvendi i Punës së FBK-së

Më 26 Mars është mbajtur Kuvendi i Punës i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë 26 delegatë nga 38 sa janë gjithsej.

Në Kuvend është folur për punën që është bërë nga Federata e Basketbollit e Kosovës në vitin 2021, si dhe është diskutuar për punët që janë në plan për vitin 2022.

Në fillim është bërë Aprovimi i Procesverbalit nga Kuvendi i Punës 30.03.2021, më pas, duke vazhduar në pikat tjera, Raporti i Punës për 12 mujorin e parë të implementimit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025, ku ka folur Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Raporti i Punës së FBK-së për vitin 2021 nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, Raporti i Auditimit për vitin 2021 nga Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Draft Plani i Veprimit 2022 nga Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Draft Plani Financiar 2022 nga Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Draft Plani i Marketingut 2022 nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku.

Të gjitha pikat e rendit të ditës janë miratuar njëzëri dhe nuk kishte kundërshtime, ndërsa delegatët kanë diskutuar për pika të ndryshme, në të mirë dhe zhvillimit të basketbollit të Kosovës.

Rendit i ditës

Zgjedhja e Trupave Punues

Kryesisë së Punës

Komisionit Verifikues

Procesmbajtësit

Aprovimi i Procesverbalit nga Kuvendi i Punës 30.03.2021

Raporti i Punës për 12 mujorin e parë të implementimit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025

Raporti i Punës së FBK-së për vitin 2021

Raporti i Auditimit për vitin 2021

Draft Plani i Veprimit 2022

Draft Plani Financiar 2022

Draft Plani i Marketingut 2022

Ndryshimet Statutare

Të ndryshme





Marigona Hill Prishtina fiton Kupën e Kosovës për U14



Peja DT fiton Kupën e Kosovës për U12

Skuadra e Peja DT ka fituar Kupën e Kosovës për grupmoshën U12 në konkurrencën e meshkujve, ndërsa Final 4 (26-27 Mars) i këtij turneut është mbajtur në Rahovec.

Në gjysmëfinalen e parë Peja DT ka shënuar fitore kundër Ylli 04 me rezultat 42:16, ndërsa në gjysmëfinalen e dytë, SHB Halit Hoxha ka mundur Marigona Hill Prishtinën me rezultat 36:32.

Ndërkohë, në finale, Peja DT ka triumfuar ndaj SHB Halit Hoxha, me shifrat 40:32.

MVP i këtij turneu është shpallur Edon Taraku i Pejës DT, çmim të cilin e ka ndarë Alban Rama, anëtar i Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës. Rama po ashtu ka dorëzuar trofeun e Kupës për skuadrën fituese.





Diellza Shaqiri-Kelmendi viziton FBK-në, flasin për projektet e përbashkëta

Koordinatorja e Vlerave Olimpike në Akademinë Olimpikë të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Diellza Shaqiri-Kelmendi ka vizituar më 29 Mars Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), ku është pritur në takim nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, Menaxherja e Eventeve dhe Basketbollit 3x3 në FBK, Artina Hasani, si dhe Asistentja Ekzekutive, Rrezarta Kqiku. Në takim është folur për bashkëpunimin ndërmjet Akademisë Olimpikë dhe FBK-së, ku të dy palët janë shprehur të gatshme për zhvillimin e projekteve të përbashkëta. Një i tillë do të zhvillohet më 6 Prill, Dita Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Paqe, ku FBK në këtë aktivitet do të kontribuojë me trajnerët, të cilët do të inkuadrohen në kuadër të eventit që do të organizohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës. Në fund Diellza Shaqiri-Kelmendi i është ndarë një fanellë e Kosovës dhe një top i basketbollit, dhuratë nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Ajo ishte pjesë e klubit të basketbollit Universiteti i Prishtinës, njëherësh skuadrës më të trofeshme në vendin tonë në konkurrencën e femrave, ku fitoi shumë trofe në basketbollin e Kosovës.





FALEMINDERIT

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

